REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**Nr. ________prot.** **Pukë, më______.______. 2025**

**Lënda:** Dërgohet për shqyrtim Relacioni dhe Projekt-Vendimi

**KËSHILLIT BASHKIAK PUKË**

Të nderuar, këshilltarë!

Bashkëlidhur, ju dërgojmë për shqyrtim Relacionin dhe Projekt-Vendimin nr.03, datë 15.05.2025

***"Për Dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Agron Keçani."***

Faleminderit për bashkëpunimin!

**KRYETARI**

**Rrok DODAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PUKË -

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PUKË**
**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Nr. ________ prot.** **Pukë, më ____.____. 2025**

**RELACION**

**Mbi**

**PROJEKT VENDIMIN**

**Nr. 03, datë 15.05.2025**

**PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI" I BASHKISË PUKË**

**Z. AGRON KEÇANI**

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa "m"; ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërise", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, sheshevе, territoreve, institucioneve dhe objeketeve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, sjellim për miratim këtë projektvendim, i cili është vijimësi e vlerësimit të disa figurave që kanë lënë gjurmë me rolin dhe kontributin e tyre, duke i shërbyer atdheut dhe kombit në rrugën e tij drejt zhvillimit dhe prosperitetit.

Emri i z.Agron Keçani, i propozuar për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë, pasi ka ka kaluar Komisionin Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, paraqitet sot për këtë vlerësim, duke çmuar rolin e tij prej një biznesmeni të suksesshëm në Itali, përmes së cilit ka arritur të nxjerrë në pah vlerat më të mira të komuintetit shqiptar, si dhe për kontributin e vazhdueshëm si humanist, pasi prej vitesh, z. Keçani mbështet shumë familje në nevojë të Pukës, si dhe disa institucione arsimore, duke u krijuar kushtet optimale për veprimtarinë e tyre.

Nisur nga rol, i faktuar përmes veprave konkrete, ju ftoj t'a votoni këtë projekt-vendim!

Bashkëlidhur:

1. ***PROJEKT VENDIMI, Nr. 03, datë 15.05.2025, PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI" I BASHKISË PUKË Z. AGRON KEÇANI.***
2. *Dokumentacioni njohës mbi jetën dhe veprën e tij .*
3. *Miratimi i Komisionit Këshillimor.*

**Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**

**Sokol Gjoni**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PUKË**
**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Nr. ________ prot.** **Pukë, më ____.____. 2025**

**PROJEKT VENDIM**

**Nr. 3 datë 15.05. 2025**

**PËR**

**DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" I BASHKISË PUKË**

**Z. AGRON KEÇANI**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa "m"; ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërise", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objeketeve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Këshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë_______.05.2024;

**Vendosi:**

1. T'i akordojë titullin "QYTETAR NDERI" i Bashkisë Pukë.

**Z. AGRON KEÇANI**

*Me motivacionin:*

***"Për rolin e tij në afirmimin e vlerave më të mira të komunitetit shqiptar në Itali, sipërmarrës i suksesshëm dhe një nga kontribuotorët e binjakëzimit të Bashkisë Pukë me Komunën e Signas, humanist dhe vizionar i përkushtuar në dobi të vendlindjes".***

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

**Paraqiten projektin;**

| Drejtori i Menaxhimit të BNJ. | Juristi | Kryetari |
|---|---|---|
| Sokol Gjoni | Endrit Kraja | Rrok Dodaj |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË

**JETËSHKRIM**

**Agron Keçani**

Agron Mark Keçani u lind më 15 .09. 1979 në fshatin Bugjon të Pukës. Me moshen 11 vjeçare mbeti jetim pasi babai i tij humbi jeten.Në vitin 1991 u shpërngul nga vendlindja drejt Tiranës, ku edhe përfundoi arsimin e mesëm në Kamëz. Në kërkim të një të ardhmeje më të mirë, në vitin 1999 emigroi vetem drejt Italisë, ku pas shumë përpjekjesh dhe sakrificash, arriti te pajiset me letra madje duke fjetur rrugash e duke hanger ne Karitas u perballur me shume sfida. Ne vitin 2004 themeloi kompaninë e tij private, të cilën e drejton me sukses prej më shumë se 20 vitesh.

Sot, Agron Këçani është një nga sipërmarrësit shqiptarë më të suksesshëm në rajonin e Toskanës, konkretisht në qytetin e Pistoias. Prej 8 vitesh, ai është president i Qendrës së Sipërmarrësve Shqiptarë "CNA Word Albania ", një strukturë që përfaqëson me dinjitet të gjithë sipërmarrësit shqiptarë në këtë rajon qe jane antare te CNA-se.Gjithashtu, ai mban edhe postin e zëvendëskonsullit në Pistoia, duke qenë urë lidhëse ndërmjet komunitetit shqiptar dhe institucioneve italiane. Agron Këçani nuk e ka harruar asnjëherë fshatin e tij të lindjes, Bugjonin. Ai ka dhënë kontribute të shumta për sistemimin e varrezave të fshatit, si dhe në rregullimin e ndonjë rruge apo nevojë tjetër konkrete të komunitetit. Në raste të vështira, si kur kanë ndodhur zjarre apo dëmtime të shtëpive, ai ka ndihmuar familjet e prekura me mjete financiare, duke u treguar gjithmonë i gatshëm për të qenë pranë vendlindjes

Kontributi i tij për vendlindjen vazhdon te rritet çdo dite , edhe pertej fshatit te lindjes , e pikerisht ne shkollën "Ali Bytyçi" në Qerret, prej gati dy viteve duke dhuruar pako ushqimore për çdo festë ,për Pashkë, ashtu edhe për Krishtlindje,si dhe uniformen shkollore per nxenesit e kesaj shkolle, pa harruar edhe materiale të tjera të domosdoshme për nxënësit. Për më tepër, ai ka mbështetur familjet në nevojë të komunitetit te fshatit Qerret, gjithashtu ne vitin 2019, ai dërgoi shume ndihma me kamione gjatë kohës së tërmetit në Shqipëri duke i derguar nga Italia per ne Shqiperi , ku keto kontribute mbeten te çmuara dhe me vlerë të madhe njerëzore.

Sot, ai është duke kontribuar edhe për realizimin e një parku lodrash në qytetin e Pukës, një projekt që do t'i japë jetë e gjalleri femijeve te qytetit te Pukes.

Por vizioni i tij nuk ndalet këtu. Z. Agron Këçani ka shprehur përkushtimin e tij për të ndërtuar një bashkëpunim të ngushtë dhe afatgjatë me Bashkinë e Pukës, duke përfshirë menaxherë, ekspertë dhe personalitete të shquara nga Italia e më gjerë. Gjithashtu eshte nje kontribues i binjakzimit te Bashkise Puke me Komunen e Signias.Ka një dëshirë të thellë që një ditë të kthehet e të japë kontributin e tij të çmuar edhe në Shqipëri, ashtu siç ka bërë me sukses në Itali. Agroni është një shembull frymëzimi për të gjithë ata që jetojnë jashtë, por që zemrën e kanë te rrënjët e tyre.Ai vetë është i gatshëm të jetë një nga motorët kryesorë të këtij transformimi.

Për vizionin e tij largpamës, për dashurinë dhe përkushtimin ndaj vendlindjes, për kontributin e palodhur në dobi të komunitetit dhe për krenarinë e tij ai i ka dhënë emrit shqiptar në diasporë nje peshe shume te madhe.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PUKË**
**KOMISIONI KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT VENDOR TË NDERIT**

**Nr. ________ prot.** **Pukë, më ____.____. 2025**

**MIRATIM**

**PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI" I BASHKISË PUKË**

**Z. AGRON KEÇANI**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërise", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objeketeve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", si dhe VKB nr.70, datë 27.12.2024, "Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë"; pasi u njohëm me materialet dhe dosjen e plotë, përmes së cilës dokumentohet roli i z. Agron Keçani, si një biznesmen i suksesshëm në Itali, por dhe si një humanist, duke kontribuar në ndihmë të shumë familjeve të varfra në territorin e Bashkisë Pukë, në ndihmë të institucioneve arsimore, por veçanërisht për vlerat e tij në procesin e binjakëzimit të Bashkisë Pukë me Komunën e Signas, shprehemi unanimisht për vlerësimin e tij të merituar nga Bashkia Pukë si "Qytetar Nderi".

KOMISIONI KËSHILLIMOR

1. Sokol Gjoni ______________
2. Denisa Meçi ______________
3. Endrit Kraja ______________
4. Rasim Laçi ______________
5. Ylli Hadroj ______________


LETERNJOFTIM ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

mbiemri/surname
**Keçani**
emri/given name
Agron
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Bugjon, ALB
datelindja/date of birth
15-09-1979
data e lëshimit/date of issue
20-02-2020
autoriteti lëshues/authority
MPB

nr. letërnjoftim/card no.
035879627
gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
**19-02-2030**
nr. personal/personal no.
**H90915098P**

firma/signature